



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 02.02.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9723, datë 03.05. 2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduart Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë: Pandeli Majko, Tom Doshi, Fatmir Mediu, Mhill Fufi

Të ftuar:

Pranvera Kastrati – përgjegjëse sektori pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Vasilika Vjero – drejtoreshë e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit

Liljana Halimi – përgjegjëse sektori pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit

Ardit Çollaku – këshilltar i ministrit

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Në rendin e ditës kemi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9723, datë 03.05. 2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar”.

Me sa shoh nga firmat, ministria inicuese e projektit qeveritar është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për momentin janë të pranishëm: zonja Pranvera Kastrati, përgjegjëse e sektorit në ministri, zonja Vasilika Vjero, drejtoreshë e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, zonja Liljana Halimi, po në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe zoti Ardit Çollaku, këshilltar i ministrit.

I thoni ministrit, që herë tjetër, kur sjell projektligje të tilla, ministri apo zëvendësministri duhet të jenë të paktën në përfaqësimin në parim. Gjithsesi, ne jemi të detyruar të vazhdojmë.

Kush do ta bëjë një prezantim të shkurtër për projektin?

Zonja Kastrati?

Pranvera Kastrati – Faleminderit!

Projektligji që kemi propozuar dhe amendimet e tij synojnë që të arrijnë disa objektiva njëherazi, duke filluar nga mundësimi i regjistrimit *online* për biznesin dhe për këtë paraprakisht Qendra Kombëtare e Regjistrimit ka filluar punën për të garantuar mundësinë e aplikimit *online* menjëherë sapo ky ligj të miratohet dhe të hyjë në fuqi. Kjo do të lejojë që bizneset përveç mundësisë që kanë sot për të shkuar pranë sporteleve të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, qofshin këto në qendër apo dhe në sportelet e decentralizuara, të kenë mundësi të regjistrohen edhe *online*, duke bërë në këtë mënyrë të panevojshëm ballafaqimin me sportelet dhe me QKR-në në të gjitha rastet fizikisht.

Gjithashtu, Qendra Kombëtare e Regjistrimit në momentin që është krijuar, pati dhe funksione, të cilat lidheshin me licencimin, funksione të cilat pas miratimit të ligjit “Për lejet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë” janë funksione të cilat kryhen tërësisht nga Qendra Kombëtare e Licencimit. Si e tillë, projektligji propozon që këto funksione të ndahen përfundimisht dhe të mos ketë asnjë ekuivok për ndonjë hapësirë që këto funksione të kryhen nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Praktika e deritanishme për sportelet në rrethe, qofshin këto sportelet në njësitë e pushtetit vendor apo në dhomat e tregtisë, ka treguar që performanca e këtyre sporteleve është shumë e

rëndësishme në kryerjen e funksioneve të QKR-së, dhe si e tillë janë propozuar disa ndryshime, të cilat do të mundësojnë që cilësia e atyre që do të përzgjidhen për të punuar në këto sportele të jetë e mbikëqyrur nga titullari i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit duke pasur në konsideratë që, pavarësisht se këto shërbime ofrohen nëpërmjet pikave të decentralizuara në të gjithë territorin e Shqipërisë, ato ndikojnë cilësisht në procesin e regjistrimit dhe performanca e njerëzve të cilët do të përzgjidhen nga njësitë e pushtetit vendor vlerësohet, mbikëqyret edhe nga titullari i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Disa parashikime të tjera në këtë ligj janë edhe harmonizimi i statusit, i kalimit në statusin pasiv që parashikon ligji për QKR-në dhe ligji “Për procedurat tatimore”, kjo dhe për faktin që, sipas ligjit për QKR-në, kalimi në statusin pasiv lidhet me mosdeklarimin e bilancit dhe gjithashtu në pamundësinë për të përcaktuar numrin maksimal të subjekteve të cilat kanë detyrimin për të depozituar bilancin në QKR, gjë që sipas ligjit aktual të QKR-së me mosparaqitjen ose depozitim për dy vjet rresht të këtij bilanci, subjektet kalojnë në status pasiv. Ndërkohë që ajo që propozohet këtu, është që statusi pasiv, duke qenë se statusi pasiv sipas ligjit të QKR-së dhe atij të procedurave tatimore nuk konvergojnë plotësisht, mosdepozitimi i bilanceve të dënohej me një gjobë administrative dhe kjo nuk do të krijonte përplasje midis dy praktikave në institucionet shtetërore.

E fundit, por jo se është më pak e rëndësishme, është përafrimi që ne i bëjmë këtij ligji me direktivën 2009/101 të Bashkimit Europian, e cila kërkon nga shteti shqiptar që të marrë masa për të garantuar transparencën në mënyrë që të ketë mundësi të mbrojë interesat e palëve të treta, qofshin këto subjekte shqiptare apo dhe subjekte të huaja. Nëpërmjet këtij harmonizimi me ligjin e QKR-së pjesërisht kjo direktivë është harmonizuar edhe me ligjin e shoqërive tregtare, pra me ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe nëpërmjet këtij plotësimi që bëhet me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit kjo direktivë konsiderohet e përafruar plotësisht në legjislacionin shqiptar.

Ne besojmë, dhe nga diskutimi që kemi bërë, nga konsultimet me komunitetin e biznesit, me dhomat e tregtisë, vlerësojmë që të gjitha këto amendime që po propozohen për t’u miratuar do të jenë në mbështetje të biznesit dhe do të ndihmojnë në uljen e mëtejshme të kostove administrative për sa i takon procedurës së regjistrimit për bizneset.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Caka, si relatore, urdhëroni!

Silva Caka – Faleminderit!

E vetmja gjë që do të doja të theksoja nga qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit, përveç asaj që përmendi zonja, është një risi tjetër e këtij projektligji, është e drejta e ministrit përgjegjës për ekonominë dhe ministri i Financave, që me udhëzim të përbashkët përjashtojnë nga detyrimi për regjistrim subjektet që kanë vëllim të ulët aktiviteti, subjekte të tjera që veprojnë si punëdhënës apo si të vetëpunësuar në fusha të posaçme.

Gjithashtu, komisioni ka evidentuar edhe një ndryshim, të cilin nuk e di nëse do të ishte e duhur ta diskutojmë tani ose ndoshta në diskutimin nën për nën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, ndoshta në diskutimin nën për nën

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kush ka pyetje?

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Unë kam një pyetje në lidhje me statusin e nëpunësve të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Neni 9 përcakton që nëpunësi i QKR-së janë nëpunës civilë, ndërkohë që në nenin 10 përcakton që nëpunësit e sporteve të Shërbimit të Decentralizuar, të hapura në QKR janë nëpunës të QKR-së. Më pas thuhet që marrëdhëniet e tyre rregullohen me Kodin e Punës.

Në parim, për sa kohë kemi një ligj, i cili rregullon statusin e nëpunësit civil, është ligj i ri, ka hyrë në fuqi, i shtrin efektet e tij. Maksimalisht ky ka qenë qëllimi. Pse e keni kufizuar këtë dhe nga ana tjetër, çfarë do të ndodhë me nëpunësit e zyrave ekzistuese të decentralizuara për shkak të riorganizimit, që me sa duket, kërkohet të bëhet nëpërmjet këtij ligji për këto zyra? Çfarë do të ndodhë me ta? Ka ndonjë procedurë që i garanton ato në qëndrimin e tyre në detyrë, apo një tranzicion në këtë marrëdhënie pune që ata kanë aktualisht?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kush do të përgjigjet?

Liljana Halimi – Faleminderit!

Në lidhje me pyetjen tuaj dua të bëj një sqarim, që ligji nr. 9793 ka pësuar një ndryshim në vitin 2000 me ligjin nr. 9916, i cili ka bërë një shtesë në nenin 5 të tij dhe ka shtuar sportelet në dhomat e tregtisë. Pikërisht pika 1 e nenit 10, e nenit 9 të projektligjit që është në diskutim përfshin

sportelet në dhomat e tregtisë. Pra, nëpunësit e sporteleve të dhomave të tregtisë të rregullohen me Kodin e Punës.

Fatmir Xhafaj – Po, urdhëroni!

Vasilika Vjero – Një sqarim plotësues. Ndërkohë marrëdhëniet e punës për njësitë e qeverisjes vendore, pra për punonjësit që janë atje, do të vijojnë të mbeten ose mbështetur në Kodin Civil, ose në statusin për nëpunësin civil, sepse në fakt është vetë njësia e qeverisjes vendore, e cila është përgjegjëse për marrjen në punë dhe ata konsiderohen si punonjës të njësisë së qeverisjes vendore, bashkisë ose komunës, pavarësisht se funksioni i QKR-së është një funksion i deleguar. Ne sigurisht që garantojmë shpenzimet për mirëfunksionimin e këtyre sporteleve, por ndërkohë stafit, pra punonjësit, janë pjesë e këtyre strukturave dhe nuk preken aspak nga ky riformulim që i është bërë gjithë marrëdhënies së Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, zyrave qendrore me sportelet e shërbimit.

Njëkohësisht, një risi e ndryshimit të këtij neni ka të bëjë dhe me mundësinë që i jepet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për të hapur dhe sportele të tjera përtej njësive të qeverisjes vendore apo dhomave të tregtisë apo bashkimit të dhomave të tregtisë. Sepse aktualisht, me ligjin aktual, QKR-ja mund të hapë sportele vetëm pranë njësive të qeverisjes vendore për shkak të afërsisë së shërbimeve që ata ofrojnë me komunitetin dhe pranë dhomave të tregtisë dhe bashkimit të dhomave të tregtisë. Ndërkohë është propozuar që Qendra Kombëtare e Regjistrimit, për nevoja të saj, kur e gjykon dhe e lidh këtë me fluksin e shërbimeve, me fluksin e kërkesave për regjistrime në qytete të caktuara mund të hapë edhe ajo vetë zyra, të cilat varen nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, pra jo pranë njësive të qeverisjes vendore dhe zyra të cilat funksionojnë pranë njësive vendore.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Ju në relacion, por edhe relatorja tha se ky ligj sjell një risi që përjashton nga detyrimi për të regjistruar në QKR subjekte, punëdhënës ose të vetëpunësuar në fusha të posaçme që ushtrojnë një veprimtari me vëllim të vogël qarkullimi. Kush e përcakton vëllimin e qarkullimit?

Vasilika Vjero – Kjo përcaktohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe çdo vit në udhëzimin që del nga kjo drejtori për procedurat tatimore përcaktohen qartazi cilat janë ato subjekte që nuk kanë detyrim për t'u regjistruar pranë QKR-së në bazë të xhiros, për shembull, po

marr rastin e ambulantëve. Ambulantët janë një kategori që nuk regjistrohen pranë QKR-së, por regjistrohen direkt pranë drejtorive rajonale, të cilat varen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Çdo vit del një udhëzim që është për procedurat tatimore, është shprehur edhe në këtë projektligj që kjo pjesë rregullohet nëpërmjet udhëzimeve të përbashkëta të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Financave. Por është një gjë e superuar, sepse kjo kategori prej kohësh nuk regjistrohet pranë QKR-së.

Fatmir Xhafaj – A ka pyetje të tjera? Nuk ka pyetje të tjera. Kalojmë te diskutimet.

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Faleminderit!

Në fakt, unë kam disa probleme për këtë projektligj. Një pjesë e problemeve janë të teknikës legjislativë dhe besoj se gjatë diskutimit nen për nen do t'i trajtojmë ato. Këshilltarët e Komisionit të Ligjeve do t'i zgjidhin, besoj do të gjejnë formulimet e sakta.

Kam disa probleme që kanë të bëjnë me diskutimin në parim të këtij projektligji, probleme të cilat fillojnë nga dispozita e fundit e ligjit, sipas së cilës ju thoni se kjo dispozitë dhe ky ligj mbizotëron ndaj ligjeve të tjera. Kështu e keni shkruar në nenin 39.

Pra, ky ligj që ne po bëjmë këtu, mbizotëron ndaj të gjitha ligjeve të tjera. Kjo nuk është çështje vetëm e teknikës, se hajt se e zgjidhim se sigurisht nuk do ta shkruajmë dhe as do ta miratojmë në këtë formë, edhe pse e doni ju apo mund ta duan ata që e kanë firmosur projektligjin, por ka të bëjë edhe me disa çështje të tjera që lidhen me tërësinë e ligjit, probleme që kanë të bëjnë me titullarin e QKR-së dhe me të gjithë armatën e njerëzve që do të punojnë për të.

E para, ju e keni hequr përkufizimin që drejtuesi i QKR-së duhet të kishte një përvojë si ekonomist apo jurist, që unë mendoj se ka qenë një formulim i mirë dhe i drejtë. Të jesh drejtues i QKR-së duhet të marrësh vesh nga ligjet apo nga ekonomia. Unë besoj se ka qenë një formulim i drejtë. E keni hequr fare këtë përkufizim dhe e keni bërë blanchet të gjithë dispozitën që na vjen te statusi i titullarit, i cili do të jetë nëpunës civil. Nuk është ndonjë risi, por sigurisht e bëni shumë vulnerabël duke hequr këtë përkufizim.

Për të vazhduar më pas me pyetjen që bëri zoti Bylykbashi lidhur me statusin e punonjësve që janë në sportele. Punonjësit e QKR-së kanë statusin e nëpunësit civil, por ju bëni një devijim dhe thoni se punonjësit e sporteleve të shërbimit nuk duhet të kenë statusin e nëpunësit civil, por trajtohen me Kodin e Punës. E marrë kjo në tërësi së bashku me të gjithë pjesën që vijon me nenin 10 me mënyrën e largimit dhe emërimit të tyre, të krijon përshtypjen, besoj të bazuar,

që duam të shmangim në emëtime dhe largime, sidomos në emëtime të këtyre njerëzve që do të vijnë pas hyrjes në fuqi të ligjit, jo kriteret dhe konkurset sipas ligjit për nëpunësin civil, por duke i trajtuar ata me Kodin e Punës, qoftë emërimin që sigurisht shmang pjesën e konkurrimit dhe marrin të gjithë ata që na kanë mbetur militantë nga listat e partive politike, por edhe pastaj në pjesën e shkarkimit të të gjithë këtyre punonjësve, të cilët trajtohen gjerësisht në nenin 9 të këtij projektligji.

Duke vazhduar më pas edhe me superautoritetin që i jepet drejtuesit të QKR-së, që ky ka kompetencë edhe t'i emërojë, edhe t'i shkarkojë pa pyetur dhe pa i koordinuar këto me kryetarët e njësive vendore.

Këto besoj se janë probleme thelbësore që duhen zgjidhur në ligj dhe që më pas, pasi të diskutohen, pasi të gjendet edhe konsensusi nga deputetët e tjerë, të japim edhe mendimin në emër të grupit të Partisë Demokratike për pranimin ose jo të votimit pro ose kundër të këtij projektligji.

Sigurisht që ka edhe disa çështje të tjera, që mendoj se janë të teknikës legjislative, si: vendimi gjyqësor i paankimueshëm apo çështje të tjera, por për ne thelbësore janë ato që kanë të bëjnë me statusin dhe autoritetin që i jepet drejtuesit të QKR-së edhe me mbivendosjen e këtij ligji mbi ligjet e tjera.

Pra, të jepet përshtypja se projektligji është bërë për një njeri të caktuar, ky njeriu i caktuar do ta bëjë vetë edhe ligjin dhe do t'i marrë edhe punonjësit vetë, edhe do ta organizojë vetë.

Fatmir Xhafaj – Ju keni ardhur për të bërë diskutime apo për të mbajtur shënim që të reagoni?

Eduard Halimi – Ky ishte qëndrimi im fillestar në momentin e diskutimit në parim, për të vazhduar pastaj edhe nen për nen.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Halimi! A ka ndonjë gjë tjetër në parim?

Pranvera Kastrati – Unë do të përpiqem të jap përgjigje për shqetësimin rreth konstatimit për nenin 39 për dispozitat transitore. Arsyeja se pse është vendosur ky parashikim në këtë nen lidhet me praktikën e deritanishme. Ajo që kemi konstatuar ne nga legjislacioni është që, le të themi, procedura e regjistrimit, sipas këtij ligji, parashikon që regjistrimi në zyrën e bashkisë për efekt të të ardhurave, pra zyrës së taksave, duhet të mbyllet nëpërmjet regjistrimit në QKR. Ajo që kemi parë nga praktika, ka qenë që regjistrimi në zyrat e pushtetit vendor për efekt të

regjistrimit në zyrën e taksave, nuk e kanë zbatuar si të tillë në të gjitha rastet regjistrimin bërë nga QKR-ja ose nuk e kanë marrë të mirëqenë faktin që një subjekt i caktuar është regjistruar nëpërmjet QKR-së dhe kanë vijuar më tej me kërkesa shtesë.

Fatmir Xhafaj – Më falni, ju jeni juriste?

Pranvera Kastrati - Jo.

Fatmir Xhafaj –Mos e vazhdoni më këtë diskutim.

Që të jemi korrektë, se ka një kufi që unë të të mbroj, por këtu nuk të mbroj dot më. Ajo dispozitë nuk formulohet ashtu. Ai e tha që nuk është thelbësore, e la të hapur që mund edhe të mos jetë çështje mentaliteti, por në teknikën legjislativë nuk shkruhet ashtu. Kjo dispozitë mbizotëron mbi të gjitha ligjet e tjera. Nuk shkruhet. E keni bërë gabim. Ta korrigjojmë. Por jo të më japësh argumente tani.

A ka koment tjetër?

Po, zonja Halimi.

Liljana Halimi – Në lidhje me kriteret apo kërkesat e titullarit të QKR-së, ajo që është parashikuar në projektligj, ne i jemi referuar ligjit “Për nëpunësin civil”, duke mos anashkaluar edhe pjesën e anës profesionale nëse kanë mbaruar shkencat juridike apo ekonomike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qëllimi është që me emërimin të merren parasysh të gjitha kërkesat që parashikojnë aktet ligjore që do të rregullojnë ligjin “Për nëpunësin civil”. Po t’i referohemi nenit aktual të ligjit, pika 2 thotë: “Titullari i QKR-së duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme të parashikuara në nenin 12 të ligjit nr. 8549”. Pra, ligji që është shfuqizuar me ligjin nr. 152.

Për sa i përket pjesës së emërimit të nëpunësve, të shërbimit në sportelet e QKR-së, pak më parë e theksova që ligji nr. 9723 ka pësuar një ndryshim, i cili ka parashikuar një shtesë në hapjen e sporteleve pranë dhomave të tregtisë. Duke qenë se dhomat e tregtisë janë organizata, janë jo autoritete publike, është parashikuar që nëpunësit e këtyre sporteleve të rregullohen me Kodin e Punës, kurse për sa u përket nëpunësve të tjerë, ajo që është parashikuar në këtë projektligj është se titullari prapë ato detyra dhe përgjegjësi ka, nuk ka dalë jashtë kompetencës së tij. Po t’i referohemi nenit aktual, ai thotë: “Titullari përcakton kriteret të posaçme”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto paguhen nga dhomat e tregtisë.

Fatmir Xhafaj – Këta nuk janë nëpunës të administratës publike. Duhej të sqarohej që në fillim.

Liljana Halimi – Fjala “decentralizim” është te pjesa për njësinë e qeverisjes vendore, por emërimet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për sa u përket nëpunësve të sporteleve të shërbimit pranë njësive të qeverisjes vendore, ata janë nëpunës të njësive vendore. Kriteret e posaçme nga ana profesionale gjithmonë duhet të përcaktohen nga titullari dhe aktualisht janë në ligjin e QKR-së. I vetmi ndryshim është ngritja e sporteleve të pavarura, jo të decentralizuara, jo me funksion të deleguar që mund të ngrejë QKR-ja pranë njësive vendore.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Ka ndonjë gjë tjetër?

Meqenëse ka disa gjëra që duhen parë dhe për të fituar kohë për diskutimin nen për nen, edhe relatorja me kolegët e tjerë, në mënyrë të veçantë kolegu Halimi, kishin disa vërejtje konkrete, për t’u dhënë kohë e mundësi edhe ekipit të ministrisë, zonjës Kastrati së bashku me ekipin e QKR-së që të reflektojnë dhe së bashku me këshilltarët, do t’ju kërkoja që ta ndërpresim këtu.

A biem dakord?

Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Ju lutem, zoti Halimi, zonja Caka, dhe kolegët e tjerë, të cilët kishin vërejtje nen për nen, të punojnë me ekipin dhe këshilltarët që të rakordohet në mënyrë që të dakordësohemi më shpejt pastaj nen për nen, për të qenë eficientë. Biem dakord? Dakord.

Nesër është projektligji “Për qeverisjen vendore”.

MBLEDHJA MBYLLET